

SFIDAT NË MENAXHIMIN E LUMENJVE

Ibrahim RAMADANI¹

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi i potencialit hidrografik në territorin e caktuar, që në këtë rast është zgjedhë si model komuna e Rahovecit-Kosovë, ndërsa studimi mbështetet në sasinë, gjendjen ekologjike të ujërave rrjedhëse dhe veprimet humane që rrezikojnë vazhdimisht këtë resurs të pazëvendësueshëm dhe strategjik. Një nga sfidat kryesore të Komunës së Rahovecit, por edhe të Kosovës në tërësi, është problemi i mbeturinave të amvisërisë dhe kanalizimeve të cilat kryesisht lirohen drejtpërdrejtë në lumenj, si dhe eksploatimi i inerteve, ndërsa pasojat nga ndotja e ujit dhe shkatërrimi i shtretërve të lumeneve janë tejet serioze dhe me rrezik permanent për popullsinë e këtyre zonave. Menaxhimi i keq i lumenjve përcillet me pasoja të rënda. Moskujdesi ndaj lumenjve, keqmenaxhimi e keqpërdorimi i tyre ka sjellë përmbytjen e shpeshtë të tokave dhe vendbanimeve. Kjo gjendje e krijuar tani reflektohet negativisht në bilancin e ujit, florën, faunën dhe në aktivitetet njerëzore.

Fjalë kyçe: *lumenj, resurs strategjik, ndotje, degradim, vërshime.*

SUMMARY

The purpose of this paper is to assess the hydrographic potential of certain territory, which in this case is chosen as a model municipality of Orahovac- Kosovo, and the study is based on the amount, the current ecological state of water and human actions that threaten constantly this irreplaceable and strategjik resource. One of the main challenges of the municipality, but also in the whole of Kosovo, is the problem of household waste and sewage which mainly released directly into rivers, as well as exploitation of inert materials, while the consequences of water pollution and destruction of riverbeds are extremely serious and permanent danger for the population of these areas. Mismanagement of the rivers followed by serious consequences. Neglect to rivers and mismanagement has brought frequent flooding of agricultural lands and settlements. This situation now reflected negatively on the water balance, flora, fauna and human activities.

¹ **Assoc.Prof.Dr. Ibrahim RAMADANI**, ibrahimramadani@yahoo.com
University of Prishtina, Geography department, www.uni-pr.edu
Tel. +37744 139 730; Fax: ++381 38 549 872
Address: 10000, Str. "Nëna Terezë" no.no., Prishtinë, Kosova

1. HYRJJE

Uji si element themelor i mjedisit dhe njëri nga elementet më të domosdoshme për zhvillimin e jetës ka rëndësi të madhe për njerëzit, për ekosistemet dhe organizmat e tjerë që jetojnë në të dhe planetin në përgjithësi.² Mirëpo, meqenëse njeriu është faktor dominant në mjedis, shpeshherë nga ai varet edhe bilanci i ujit, sasia dhe cilësia e tij në hapësirën e caktuar. Me një përkushtim dhe kujdes më të madh, e sidomos me ndërtimin e pendave, njeriu ndryshon sasinë dhe rrjedhën e ujit në mjedis duke krijuar akumulacione në formë të liqeneve artificiale. Këto ujëra pastaj mund të përdoren për furnizim të vendbanimeve, industrisë, ujitjen e tokave ose përfitimin e energjetikës etj.³ Tani më uji është një ndër resursët më kritikë me të cilin po përballlet njerëzimi. Meqenëse popullsia është në rritje, edhe konsumimi i ujit i ka kaluar kufijtë. Sot është krijuar një shpërputhje ndërmjet rezervave dhe kërkesave në rritje të njerëzimit për ujë. Përveç kësaj, mundësitë e furnizimit me ujë janë ngushtuar si pasojë e ndotjes. Shumë lumenj dhe liqene janë bërë vende për hedhje të mbeturinave, përfshirë ujërat e zeza urbane dhe industriale, depërtimi i kimikaleve të rrezikshme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktivitetet bujqësore, etj. Problemi i ndotjes së ujit është shqetësues nga fakti se kjo dukuri ka marrë përmasa dramatike. Sot janë pak vende në botë, qoftë në zhvillim apo të industrializuara, që kanë mbrojtje adekuate të ujërave, monitorim të cilësisë së ujit dhe kontrollin e ndotjes. Shumë vende nuk kanë standarde për të kontrolluar në mënyrë adekuate ndotjen e ujit, derisa të tjerat nuk kanë mundësi të zbatojnë standardet e cilësisë së ujit.

Përdorimi i qëndrueshëm i resurseve ujore nënkupton përdorimin e planifikuar në mënyrë racionale, me qëllim që të mos shkaktohet dëmtimi i ekosistemeve natyrore të cilat janë të nevojshme për gjeneratat e ardhshme.⁴ Edhe pse sasia e ujit të ëmbël është e kufizuar, megjithatë kjo sasi e ujit është shumë më e madhe se kërkesat e tanishme të popullsisë, por problemi qëndron në shpërndarjen e pabarabartë ndërmjet regjioneve.⁵ Ujërat rrjedhëse në territorin e Kosovës ndahen në katër pellgje kryesore lumore. Sasia mesatare vjetore e këtyre ujërave vlerësohet në 3648 milion m³, mirëpo me dallime të konsiderueshme ndërmjet tyre, nga 58.5% në pellgun e Drinit, 28.2% në atë të Ibrit, 7.2% në pellgun e Lepencit dhe 5.8% në pellgun e

² R. Castensson: The Question of Water, Ambio N 4/, Stockholm, 1986, p 13

³ I. Ramadani, Menaxhimi i resurseve natyrore, Prishtinë, 2013, p 142

⁴ I. Ramadani, Menaxhimi i resurseve natyrore, Prishtinë, 2013, p 119

⁵ Geografija, <http://www.geografija.hr/clanci/166/ima-li-dovoljno-vode-za-sve> (21.5.2012)

Moravës së Binçës. Këto dallime të mëdha janë si pasojë e shpërndarjes territoriale jo të njëjtë të reshjeve në Kosovë, që janë faktor me rëndësi edhe për prurjet lumore dhe regjimin hidrologjik. Në bazë të disa krahasimeve Kosova me 1700 m³/b/vit konsiderohet si vend shumë i varfër me ujë.⁶ Sasia më e madhe e ujit në Kosovë shfrytëzohet nga bujqësia me rreth 270 milion m³, ose 55%, kurse një sasi e konsiderueshme shfrytëzohet nga vendbanimet dhe industria.⁷ Shumë pjesë të Kosovës konsiderohen si relativisht të thata dhe me mungesë të ujit të mjaftueshëm. Prandaj, në përmirësimin e rezervave të ujit të një vendi rol të rëndësishëm ka ndërtimi i akumulacioneve artificiale, edhe pse ky problem përcillet me financime të mëdha.⁸

Tani më është momenti kur duhet të ndërmerren aksione për t'i mbrojtur lumenjtë nga degradimi i tyre i plotë. Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave urbane dhe industriale në ujë rezulton me ndotjen e burimeve të ujit të pijshëm. Planifikimi dhe organizimi i menaxhimit, në përputhje me konceptin e IWRM, bëhet në nivel të pellgut të lumit (baseni i lumit). Zona e pellgut të lumit paraqet njësinë hapësinore logjike dhe praktike për menaxhimin e ujërave. Qasja e menaxhimit në nivel të zonës ujëmbledhëse mundëson zgjidhjen e konflikteve ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara në kuadër të sistemit të përgjithshëm hidrologjik, që shpeshherë nuk është e mundur të arrihet në nivel të njërive menaxhuese administrative, të cilat përfshijnë vetëm disa pjesë të pellgjeve ose baseneve të caktuara. Zgjedhja e lokacionit për realizimin e monitorimit duhet të përfshijë: zonat industriale, punëtoritë, deponitë e mbeturinave komunale dhe industriale etj.⁹ Ruajtja e rezervave të ujit të pastër dhe zvogëlimi i nivelit të ndotjes në procesin e shfrytëzimit janë objektivat themelore të këtij shekulli, ngase njerëzimi si dhe e gjithë bota e gjallë në planetin tonë është e varur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sasia dhe cilësia e ujit. Në reduktimin e sasisë së ujit ndikojnë: ndotësit e ndryshëm të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, rritja e nevojave të konsumit të ujit nga popullsia dhe industrisë gjithnjë në rritje, si dhe nevojat për ujitje në bujqësi dhe prodhimin e ushqimit.¹⁰

⁶ R. Pllana, V.Pruthi,: Resurset ujore dhe sfidat në Republikën e Kosovës, Prishtinë, 2010, p 66

⁷ Po aty, p 65.

⁸ I. Gusia: Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës, Prishtinë, 1982, p 33

⁹ Z. Nakić: Ekologija okoliša, Zagreb, 2010, p 89

¹⁰ I. Ramadani, Menaxhimi i resurseve natyrore, Prishtinë, 2013, p 87

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave është domosdoshmëri në kushtet e rritjes së popullsisë dhe ngarkesës së shtuar në resurset ujore.¹¹ Lidhur me të drejtën për përdorimin e ujit vlen parimi: uji si e drejtë, por mbrojtja si përgjegjësi.¹² Sfidë kryesore për ne tani më është problemi se si të mbahet baraspesha ndërmjet kërkesës për ujë dhe furnizimit me ujë, me qëllim të ujitjes së tokave, funksionimit të industrisë, furnizimit të qyteteve pa shkaktuar dëme në natyrë dhe ekosisteme. Menaxhimi i Integruar i Ujërave (Integrated Water Resources Management IWRM) është një instrument i vlefshëm për këtë qëllim. IWRM synon të sigurojë zhvillimin e koordinuar dhe menaxhimin e ujërave, tokës dhe resurseve të tjera, duke e rritur maksimalisht mirëqenien ekonomike dhe sociale pa ndikime negative në qëndrueshmërinë e ekosistemeve natyrore.¹³ Nga aspekti ekonomik, parimi "ndotësi paguan" tani më nënkupton se ndotësi i cili shkakton dëmtime në sistemin e ujit duhet të paguajë kompensimin dhe shpenzimet për sanimin e dëmeve.¹⁴ Rregullorja Kornizë për ujërat (WFD) është një nga parimet më të plota dhe më ambicioze të BE-së dhe mund të shihet si përgjigje në Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (IWRM). Kjo nuk është detyrë e lehtë dhe kërkon përpjekje në shumë nivele, nga përdoruesit individual e deri te nivelet më të larta administrative.

2. MATERIALET DHE METODAT

Si objekt hulumtimi në këtë rast është marrë rrjeti hidrografik i komunës së Rahovecit në një territor prej 275 km², ndërsa ky material mund të përdoret si metodologji për trajtimin e ujërave në planet hapësinore të komunave tjera. Grumbullimi i të dhënave për këtë studim është ndihmuar nga sektori komunal për mjedis dhe ujëra, puna në terren dhe literatura tjetër ndihmëse. Me ndihmën e ortofotove dhe GIS-it është bërë analiza e gjendjes ekzistuese, sikurse dendësia e rrjetit hidrografik, potenciali i burimeve dhe vijave rrjedhëse, identifikimi i pikave problematike lidhur me ndotjen, nxjerrjen e

¹¹ UNCED: UN Conference of Environment and Development – AGENDA 21, *Protection of the Quality and Supply of Freshwater Resources, Application of Integrated Approches to the Development, Management and Use Éater Resources*. UN Geneve, 1992.

¹² R.Pllana, V. Pruthi, Resurset ujore dhe sfidat në Republikën e Kosovës, Tryezë shkencore, Prishtinë, 2010, p 65

¹³ I. Ramadani, Menaxhimi i resurseve natyrore, Prishtinë, 2013, p 122

¹⁴ *Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council of 23 October 2000 establishing a Framework for Community Action in the Field of Water Policy. No. L 327.*

inerteve dhe zonat e rrezikuara nga vërshimet, ndërsa të gjitha këto janë konkretizu me harta dhe tabela, të cilat ndihmuan në nxjerrjen e konkluzave për veprim të mëtejshëm.

3. DISKUTIMI DHE REZULTATET

Me rastin e studimit të rrjetit hidrografik të territorit të caktuar doemos duhet të merren në konsideratë edhe faktorët tjerë të mjedisit si: ndërtimi gjeologjik, pozita gjeografike, relievi, e sidomos kushtet klimatike. Ndërtimin gjeologjik të territorit të Komunës së Rahovecit e përbëjnë formacionet e periudhave të ndryshme të Pleistocenit, Pliocenit, Kretakut dhe Jurasikut. Formacionet e holocenit dhe Jurasikut ndërtonjnë fundin e luginës së Drinit të Bardhë, me rrafshet aluviale, ndërsa formacionet e kretakut dhe jurasikut ndërtojnë pjesën lindore dhe veriore, me shkëmbijë gëlqeror, formacionet diabazike dhe serpentine. Njëri nga faktorët më të rëndësishëm natyror që ndikon në hidrografinë e një regjioni është klima. Ndërsa, kjo kushtëzohet nga shumë faktor tjerë të rëndësishëm si: pozita e gjeografike, largësia nga deti, lartësia mbidetare, vegjetacioni etj. Ndryshimet klimatike kanë një ndikim të përherëshëm në burimet dhe menaxhimin e ujit. Rritja e temperaturave në shumë vende të ndryshme të botës ndikon në regjimin e reshjeve dhe rritë rrezikun e thatësirave, përmbytjet dhe fatkeqësitë e tjera që lidhen me ndryshimet e shpejta të regjimit të ujit. Lartësia mesatare e territorit të Komunës së Rahovecit është 550 m, largësia nga Deti Adriatik është rreth 100 km, kurse territori është i mbrojtur nga erërat veriore dhe është i mbuluar relativisht mirë me vegjetacion. Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini i Bardhë. Klima është relativisht e butë dhe pa variacione ekstreme të temperaturave të ajrit gjatë vitit. Sasia mesatare e reshjeve vjetore me rreth 800 mm dhe formacionet kretake e jurasike në pjesën veriore dhe lindore reflektohen relativisht mirë në rrjetin hidrografik të këtij territori.

3.1. Hidrografia

Rrjeti relativisht i dendur hidrografik paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një nga kushtet ekzistenciale për botën bimore dhe zhvillimin e aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puse, burime rrjedhëse të qëndrueshme, si dhe

disa projeje periodike. Burimet janë forma të rëndësishme hidrografike. Numri më i madh i burimeve gjenden në luginat e projejeve dhe rrëzë kodrinave, në anën lindore dhe veri-lindore të Rahovecit. Shumica e burimeve ndodhen në luginën e Rimmikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug-perëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozë, Zatriq dhe Kaznik. Vendbanimet shtrihen kryesisht përgjatë luginave lumore, si dhe në afërsi të burimeve ujore: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishtit, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasella, Kramaviku e tjerë.


Tabela 1. Vendburimet¹⁵

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Litra/sek.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8
Burimi i Zatriqit	920	5
Burimi i Apterushës	400	40
Burimi i Zaçishtit	415	15
Burimi i H.Madhe	420	10
Burimi i Sopotit	380	6

Të gjitha rrjedhjet lumore që vijnë nga këto burime periodike dhe të përhershme derdhen në lumin kryesor Drini i Bardhë. Lumenjtë të cilët derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi i Ratkocit, Rimmikut, Palluzhës, Hoçës, etj.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit është e gjerë rreth 2 deri 5 km, gjerësia mesatare e shtratit të lumit arrin deri në 100 m, ndërsa thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m. Hapësira nëpër të cilën kalon lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror të Gradishit, duke formuar grykën (kanjonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në këtë kanjon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra, kurse lartësia prej harkut deri te sipërfaqja e ujit të lumit është rreth 30 m.

¹⁵ Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit, 2013.




Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë e Madhe, në lartësi mbidetare 420 m, dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, ndërsa në afërsi të fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindolit dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhle i cili buron në Rahovec formohet nga tri burime kryesore dhe bashkohet me lumin e Rimmikut. Lumi Rimmik buron në rrëzë të malit Gërgavicë, kurse gjatë rrjedhjes së tij integron disa burime të tjera. Ky lum ka

rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimmik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me rrjedhën Duhle dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpal, Sopniq etj. Përveç këtyre, janë edhe disa rrjedhje lumore dhe proje, të cilat e pasurojnë rrjetin hidrografik dhe rrisin vlerën ekonomike dhe ekologjike të kësaj komune.

3.2. Rrezikimi i lumenjve nga ndotja dhe degradimi

Rrjetin hidrografik në këtë territor e përbëjnë disa qindra burime në formë të puseve dhe burime rrjedhëse të qëndrueshme. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet e shpateve dhe të luginave, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrinat përreth Rahovecit etj. Të gjitha këto burime janë larg ndotjeve urbane dhe ndikimeve antropogjene, andaj duhet mbrojtur dhe trajtuar edhe mëtej si dukuri hidrologjike për nevojat e popullsisë dhe botës shtazore që jeton pranë tyre. Mirëpo, lumenjtë të cilët kalojnë nëpër vendbanime ose pranë tyre janë në gjendje jo të mirë sa i përket ndotjes. Në bazë të hulumtimeve në terren është vërtetuar se të gjithë shtretërit e lumenjve janë kthyer në deponi mbeturinash të amvisërisë si dhe janë atakuar nga shkarkimet e ujërave të zeza pa asnjë trajtim paraprak, psh: lumi Rimmik, Palluzhë, Hoçë, Sopniq, Duhle, Bellajë etj. Lumi Drini i Bardhë mbledh ujin



e të gjitha përrrojeve dhe disa lumenjve të cilat e rrisin nivelin e ndotjes në të. Nëpër komunën e Rahovecit lumi Drini i Bardhë rrjedh me një gjatësi prej 30 km, i cili në pjesën më të madhe merret si kufi administrativ me katër komuna tjera si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës, ndërsa të gjitha komunat e lartpërmendura i shkarkojnë ujërat e zeza në këtë lum pa as një trajtim paraprak. Sipërfaqet e degraduara janë prezent përgjatë tërë shtratit të lumit Drini i Bardhë ku në mënyrë të pa kontrolluar është shkatërruar shtrati i

lumit dhe si pasojë e kësaj shkaktohen edhe vërshimet e herë pashershme në këtë zonë. Vendbanimet më të rrezikuara nga vërshimet, bashk me tokat bujqësore, që janë në kërcenim të përhershëm janë:

Kramoviku, Qiflaku, Dabidoli, Dejna, Ratkoci, Radosti, Gexha, Xerxa dhe Krusha e Madhe, të cilat shtrihen në të dy anët e lumit. Nga Kramoviku e deri në Krushë të Madhe janë identifikuar një numër i madh i pikave problematike që paraqesin rrezik për vërshimin e sipërfaqeve të konsiderueshme bujqësore.

Parandalimi i veprimtarisë së kompanive që merren me eksploatimin e zhavorreve është masë preventive. Për këtë arsye duhet të bëhet monitorimi permanent i degradimit të shtratit të lumit Drini i Bardhë në territorin e kësaj komune dhe në koordinim me MMPH, gjegjësisht inspektoratin për mjedis, duhet që sa më parë të merren masa për parandalimin e kësaj veprimtarie.



Fig. 1. Shkatërrimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë



Fig. 2. Menaxhimi i drejtë i lumit

Rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara është i kushtueshëm, andaj komuna paraprakisht duhet të fillojë me parandalimin e eksploatimit të zhavorrit në lumenj si masë preventive.

Shfrytëzimi i këtyre inerteve mund të bëhet vetëm përmes projekteve të veçanta, me kusht që dëmet mjedisore të jenë sa më të vogla dhe zona mund të rigjenerohet shpejt. Gjithashtu edhe menaxhimi i dobët i hedhurinave në nivel të komunës ka ndikuar në krijimin e gjendjes alarmante në lumenj të cilët po shndërrohen në deponi mbeturinash.

4. KONKLUZAT

Komuna e Rahovecit, në radhë të parë, përballet me problemin e vërshimeve, ngase ujërrjedha e lumit të Drinit të Bardhë, por edhe të degëve të tij gjatë sezonës së shirave dhe shkrirjes së borës shkatërrojnë të mirat materiale si dhe tokat bujqësore. Sipas vlerësimeve të Hidroekonomisë së Kosovës sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet janë rreth 2554 ha, ndërsa në rrezik permanent janë 612 hektar tokë të cilsisë së lartë. Me qëllim të evitimit ose zvogëlimit të dëmeve në rrethinën e tyre këta lumenj duhet të monitorohen dhe menaxhohen me kujdes. Rregullimi dhe zgjerimi i shtretërve të lumenjve do të minimizonte pasojat. Në këta lumenj rekomandohet që të bëhet zgjerimi i shtretërve aq sa do të përballonin vëllimin e ujit me rastin e fryrjes së tyre. Masë tjetër është zbutja e lakesave të forta të lumit, mënjanimi i pengesave në lumenj dhe përcaktimi i pikave për monitorimin dhe menaxhimin e brigjeve të lumenjve. Në këtë rast do të ishte mëse e nevojshme që pronarët e tokave të kujdesen për mirëmbajtjen e gjelbërimit-drunjve përgjatë lumit dhe largimin e degëve pas prerjes së tyre.

Gjithashtu edhe ndalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj, që paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit, duhet të bëhet sa më parë.

Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve të lumenjve nga shkatërrimi, organet kompetente për mbrojtjen e mjedisit duhet të ndalojnë çdo lloj aktiviteti që ka të bëjë me nxjerrjen dhe shfrytëzimin e inerteve. Ndërsa, brezi i gjelbër në distancë prej 10 metra nga vija e ujit duhet të mbrohet me kujdes dhe të jetë i përhershëm. Gjithashtu edhe ndërtimet në zonat e banuara duhet të përmbahen distancës nga vija lumore, ndërsa hapësira e lirë ndërmjet vijës lumore dhe vijës së ndërtuar të jetë e gjelbëruar me barë dhe drunj dekorativ, që mund të shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion.

Një nga sfidat kryesore të Komunës së Rahovecit, por edhe të Kosovës është problemi i mbeturinave të amvisërisë dhe kanalizimeve, të cilat kryesisht lirohen në lumenj, ndërsa pasojat nga ndotja janë shumë serioze dhe me rrezik permanent. Në shumicën e vendbanimeve ku lumenjtë kalojnë janë vërejtur dukuri të tilla negative.

Hapat që duhet të ndermirren janë:

- Pastrimi i shtretërve të lumenjve
- Kontrolli i rrept nga organet kompetente për mjedisin
- Pajisja e vendbanimeve me infrastrukturë adekuate për mbeturinat.
- Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi nga inspektorati për mbrojtjen e mjedisit.
- Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në lumenj.
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.

Ndërsa, sa i përket mbrojtjes nga erozionit horizontal i lumenjve, sidomos në zonat e rrafshëta, mbajtja nën kontroll e tyre mund të bëhet me mbjelljen e vegjetacionit drunor përgjatë brigjeve të lumenjve. Rrënjët e drunjëve do të ndihmojnë në stabilizimin e tokës më shumë se çdo masë tjetër vepruese. Kjo do të reflektohet pozitivisht edhe në ruajtjen e habitateve të peshqve dhe organizmave të tjerë të rëndësishëm për banorët e kësaj komune. Parandalimi dhe evitimi i ndotjes së ardhur nga komunat fqinje, si dhe ajo e shkaktuar nga vendbanimet brenda komunës mund të bëhet nëpërmjet projekteve të veçanta mjedisore që do ta ndryshonin gjendjen.

REFERENCAT:

1. Castensson R; The Question of Water, Ambio N 4/, Stockholm, 1986.
2. Geografija, <http://www.geografija.hr/clanci/166/ima-li-dovoljno-vode-za-sve> (21.5.2012)
3. Pllana R. Pruthi, V; Resurset ujore dhe sfidat në Republikën e Kosovës, Tryezë shkencore, Prishtinë, 2010.
4. Gusia I; Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës, Prishtinë, 1982.
5. Nakić Z; Ekologija okoliša, Zagreb, 2010.
6. UNCED; UN Conference of Environment and Development – AGENDA 21, *Protection of the Quality and Supply of Freshwater Resources, Application of Integrated Approches to the Development, Management and Use Water Resources*. UN Geneve, 1992.
7. *Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council of 23 October 2000 establishing a Framework for Community Action in the Field of Water Policy. No. L 327.*
8. Ramadani I; Menaxhimi i resurseve natyrore, Vatra, Prishtinë, 2013.

